

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Faza Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia dhe Plani i Veprimit të AKEP për Vitin 2018-2019, miratuar me Vendimin nr. 100, datë 24.12.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	7/12/2018
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	12.03.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	PO, 13.03.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MIE dhe MD- 02
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Emri, Mbiemri, e-mail-i dhe numri i telefonit: Besmir Beja, Besmir.beja@drejtesia.gov.al ; 0692063356

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Problemi në shqyrtim është i lidhur me mos parashikimin e një rregullimi shterues lidhur me veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të publikimeve online/elektronike, si për posedues të domain nën. al dhe për ata jashtë regjimit të domaineve nën. al. Ky mos rregullim ka sjellë probleme lidhur me administrimin rigoroz të veprimtarisë elektronike të sa më sipër, si dhe nuk legjitimon ndërhyrjen e institucioneve përgjegjëse në rregullimin e veprimtarisë elektronike të subjekteve, të cilat nuk ndodhen në regjimin e Domain nën.al por që efektivisht janë të regjistruar në qendrat apo organet kompetente në Republikën e Shqipërisë, si dhe ushtrojnë aktivitet tregtar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Të rregullohet koordinimi midis institucioneve përgjegjëse dhe sipërmarrësve dhe ofruesve të shërbimeve të publikimeve online;
- Të normohet veprimtaria e shërbimeve të publikimeve elektronike;
- Të garantohet e drejta e informimit dhe lirisë së shprehjes;
- Të moslejohen publikimet që nxisin dhunën, gjuha e urrejtjes, lajmet e rreme, si dhe materialet me përmbajtje të paligjshme;

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: Status Quo-ja (vijimi me kuadrin ligjor e nënligjor ekzistues)

Opsioni 1, (i preferuar): Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Opsioni 2: Hartimi dhe reflektimi i ndryshimeve me akte nënligjore, Rregullore nr. 02, datë 21.02.2008 “Për rregjistrimin dhe administrimin e Emrave të domain-eve nën.AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .org.al dhe .net.al” të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i preferuar nuk shoqërohet me ndikim ekonomik për buxhetin e shtetit, pasi AKEP është organ publik i pavarur, i cili nuk financohet nga buxheti i shtetit. Të gjitha sistemet elektronike janë të ngritura pranë AKEP, dhe stafi është i kualifikuar për të përballuar funksionet e atribuara me ndryshimet përkatëse ligjore që priten të miratohen. Opsioni mbetet më efektiv pasi parashikimi ligjor, dhe jo nëpërmjet akteve nënligjore të nxjerrë nga organi rregullator, është i një natyre me shtrëngues dhe siguron një normim me shterues.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Në periudhën Dhjetor 2018 – Janar 2019, janë zhvilluar 4 tryeza konsultimi publik, me pjesëmarrjen e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AMA-n, Avokatin e Popullit, institucioneve të tjera publike, përfaqësues të operatorëve që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike, përfaqësues të organizmave ndërkombëtare si dhe të shoqatave që në fokus të punës së tyre kanë median por edhe të drejtat e njeriut. Gjithashtu projektligji është publikuar në datë 07.12.2018 në Regjistrin e Konsultimit publik për t’u konsultuar me palët e interesit.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Autoriteti i ngarkuar me ligj për zbatimin dhe monitorimin e detyrimeve sipas këtij ligji, është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në bashkëpunim dhe me sipërmarrësit e rrjeteve/shërbimeve elektronike dhe AMA-n.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji nr.9918/2008, “Për Komunikimet Elektronike në RSH”, i ndryshuar, është aktualisht ligji kuadër procedural dhe material, që përcakton normat dhe procedurat mbi rregullimin e fushës së komunikimeve elektronike me qëllim garantimin e ofrimit të shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në territorin e RSH.

Në momentin e miratimit të ligjit nr.9918/2008, AKEP është përcaktuar si organi i vetëm rregullator që administron domain nën.al. Natyrisht, duke patur në vëmendje faktin se fusha e teknologjisë së informacionit është një sektor tepër dinamik, me zhvillim të vazhdueshëm, mbetet e qartë se ky sektor ka nevojë gjithnjë për rregullim. Në këtë kontekst, kuadri ekzistues ligjor në fuqi nuk parashikon asnjë rregullim për veprimtarinë e subjekteve të ndryshme që ofrojnë shërbime dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet portaleve online, si dhe nuk parashikon në mënyrë shteruese nivelin e koordinimit midis institucioneve përgjegjëse dhe sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik.

Në këto kushte, duke mbajtur në fokus veçanërisht influencën e portaleve online gjatë viteve të fundit është e nevojshme që të ndërmerret një rregullim apo normim i procedurave që duhet të ndiqen nga institucionet përgjegjëse me qëllim sigurimin/respektimin e kufizimeve sa i përket materialeve me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme apo në kuadër të luftës kundër piraterisë online, si dhe rregullimi i veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve të publikimeve online.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

a) Natyra e Problemit

Problematikat e evidentuara sipas gjendjes aktuale janë të lidhura ngushtësisht me çështjet si vijon:

1. Mos parashikimi i një rregullimi shterues lidhur me veprimtarinë e ofruesve të shërbimeve të publikimeve online/elektronike, si për posedues të domain nën. al ashtu dhe për ata jashtë regjimit të domaineve nën. al, që ka sjellë probleme lidhur me administrimin rigoroz të veprimtarisë elektronike të sa më sipër. Gjithashtu nuk legjitimon ndërhyrjen e institucioneve përgjegjëse në rregullimin e veprimtarisë elektronike të subjekteve, të cilat nuk ndodhen në regjimin e Domain nën.al, por që efektivisht janë të regjistruar në qendrat apo organet kompetente në Republikën e Shqipërisë si dhe ushtrojnë aktivitet tregtar në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Numri i subjekteve që ofrojnë këto shërbime, në këto lloj forme është shtuar dhe vijon të shtohet vazhdimisht;

3. Një pjesë e madhe e subjekteve që ushtrojnë këtë veprimtari, e kryejnë jashtë regjimit të domaineve nën.al;
4. Ofruesit e shërbimeve të publikimeve online, gjithashtu nuk ofrojnë akses për paraqitjen e ankesave të mundshme, si dhe në legjislacionin aktual nuk janë të parashikuara qartësisht sanksionet ligjore lidhur me mosrespektimin e detyrimeve ligjore sa i përket kufizimeve të publikimit të përmbajtjeve të paligjshme ose të dëmshme.

b) Shkaqet e problemit

Disa nga shkaqet e tendencave të mësipërme mund të jenë pasojë e shmangies së përgjegjësisë ligjore me qëllim përfitimin më madh:

- Synimi i rritjes së numrit të klikimeve për efekte financiare (rritjen e kërkesave për kohë reklame);
- Mungesë e kualifikimeve të stafit të punësuar pranë ISP-ve;
- Mungesa e një autoriteti që garanton të drejtat dhe liritë e individëve që mund të preken nga publikimet e rreme, të pasakta, etj;
- Mungesa e përgjegjësisë administrative në rast shkeljesh administrative.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Rregullimi i veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike si dhe të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik, përmes një kornize ligjore ka si qëllim arritjen e një ekuilibri ndërmjet qasjes në shërbimet e përmbajtjes online, mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrencës, garantimin e të drejtave të njeriut, respektimin e të drejtave të autorit, si dhe respektimin apo sigurimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme.

Natyrisht, niveli i ndërhyrjes në ligjin ekzistues nuk mund të jetë gjithëpërfshirës pasi sektori i komunikimeve elektronike është tepër dinamik, por konkretisht me këto ndryshime normohet tërësisht niveli i koordinimit midis institucioneve përgjegjëse si dhe të gjithë subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet platformave online si dhe të sipërmarrësve që ofrojnë rrjete / shërbime të komunikimeve elektronike.

Projektligji është hartuar nga grupi i punës, i cili përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe ekspertë të fushës, dhe do të paraqitet pranë Këshillit të Ministrave, si bashkëpropozim i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Objekti i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi kryesor i politikës është:

- Të rregullohet koordinimi midis institucioneve përgjegjëse dhe sipërmarrësve dhe ofruesve të shërbimeve të publikimeve online;
- Të normohet veprimtaria e shërbimeve të publikimeve elektronike;
- Të garantohet e drejta e informimit dhe lirisë së shprehjes;
- Të moslejohen publikimet që nxisin dhunën, gjuha e urrejtjes, lajmet e rreme, si dhe materialet me përmbajtje të paligjshme;

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

– **Opsioni 0 - Status quo-ja:** Vijimi me kuadrin ligjor e nënligjor ekzistues.

Ligji aktual 9918/2008, nuk paraqitet i plotë në parashikimet e tij lidhur me rregullimin e detyrimeve së pari të institucioneve përgjegjëse lidhur me veprimtarinë e tyre institucionale për sigurimin e respektimit të kufizimeve që kanë të bëjnë me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, si dhe në kuadër të luftës kundër piraterisë. Gjithashtu, dispozitat e ligjit ekzistues nuk rregullojnë në mënyrë shteruese detyrimet e sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të përdoruesve kur këto çenohen nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve online, si dhe nuk parashikon ndërhyrjen në nivel organesh rregullatore të ofruesve të shërbimeve të publikimeve online të cilët kanë në posedim një domain jashtë regjimit të .al.

– **Opsioni 1: ndryshimet në ligjin ekzistues nr.9918/2008** “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (**opsioni i preferuar**):

Ky opsion siguron/përcakton në mënyrë më të qartë detyrimet e institucioneve përgjegjëse në sigurimin e respektimit të kufizimeve në lidhje me përmbajtjet të paligjshme ose të dëmshme, sigurimin e respektimit të subjekteve në kuadër të reklamimit të ankesave të tyre, parashikimin e sanksioneve të qarta në rast të shkeljeve apo mos zbatimit të vendimmarrjes së institucioneve përgjegjëse.

– **Opsioni 2:** Hartimi dhe reflektimi i ndryshimeve me akte nënligjore, Rregullore nr. 02, datë 21.02.2008 “Për rregjistrimin dhe administrimin e Emrave të domain-eve nën.AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .org.al dhe .net.al” të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP

Opsioni i mundshëm në funksion të realizimit të politikave në kuadër të kësaj nisme është dhe hartimi i një rregullore nga organi rregullator, por e tillë nuk mund të gjej një zgjidhje gjithëpërfshirëse përderisa rregullatori nuk mund të normojë me akt nënligjor veprimtarinë e subjekteve dhe institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë Ligjit nr. 9918/2008.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Përsa i përket ndryshimeve të propozuara sipas Opsionit të preferuar, ato prekin poseduesit që kanë domain nën.al, të cilët aktualisht arrijnë në 23 000 mijë të tillë, si dhe ata që nuk posedojnë domain ose nëndomain nën .al, por që janë të regjistruar pranë organeve kompetente dhe zhvillojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë.

Opsioni i preferuar nuk shoqërohet me ndikim ekonomik për buxhetin e shtetit, pasi AKEP është organ publik i pavarur, i cili nuk financohet nga buxheti i shtetit. Të gjitha sistemet elektronike janë të ngritura pranë AKEP, dhe stafi është i kualifikuar për të përballuar funksionet e atribuara me ndryshimet përkatëse ligjore që priten të miratohen.

Gjithashtu, AKEP në cilësinë e organit rregullator të sektorit të komunikimeve elektronike preket nga opsioni i preferuar. AKEP është institucion i pavarur që financohet nga burimet e krijuara me ligj dhe nuk përfiton fonde nga buxheti i shtetit, por efektet financiare i merr përsipër t'i mbulojë nga të ardhurat e veta.

Eventualisht, zgjedhja e opsionit të preferuar, do të pasjell shtimin e kostove administrative të AKEP në kuadër të krijimit, verifikimit dhe mirëmbajtjes së të dhënave apo regjistrave për subjektet të cilët kanë në posedim domaine jashtë regjimit të domaneve nën .al, si dhe të pjesës së stafit teknik që do të bashkërendojnë punën me ISP-të për marrjen e masave administrative dhe teknike për zbatimin e vendimeve të AMA-s. Natyrisht, këto kosto do të përballohen nga AKEP nëpërmjet buxhetit të tij.

Lidhur me parashikimin e ndikimit financiar sa i përket subjekteve ofrues të shërbimeve të publikimeve elektronike, kjo mbetet e pa mundur për t'u identifikuar plotësisht dhe për shkak të kompleksitetit të veprimtarisë që ofrojnë këto subjekte.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është opsioni 1, pasi ndryshimet në ligjin ekzistues krijojnë premisën e duhur ligjore për të siguruar respektimin e kufizimeve lidhur me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme si dhe përcaktimin shterues të detyrimeve të institucioneve përgjegjëse në kuadër të garantimit të detyrimeve ligjore nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike dhe sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Drejtoria e Autorizimeve dhe Drejtoria e Monitorimit, Kontrollit dhe Inspektimit pranë AKEP, do të administrojnë regjistrin e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike me domain.al dhe do të ekzekutojë vendimmarrjet e AMA-s, si dhe do të ekzekutojë vendimmarrjet e KA-së për bllokim aksesit të shërbimit, për OSHPE-të që nuk janë në regjistrat e domain-eve të administruar nga AKEP.

Si pengesë e mundshme për zbatimin e ligjit mund të jenë afatet e shkurtra të propozuara për marrjen në shqyrtim të ankesave nga Këshilli i Ankesave, AMA dhe AKEP.

Një tjetër pengesë mund të jetë edhe përcaktimi i formës dhe mënyrës së komunikimit midis organeve publike apo edhe marrja e masave për OSHPE-të që ushtrojnë aktivitet nga jashtë territorit të vendit.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

AKEP në bashkëpunim dhe koordinim me AMA-n do të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore kundrejt të gjithë sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe të poseduesve të domain nën al. me qëllim zbatimin e vendimeve të KA-së pranë AMA lidhur me respektimin e kufizimeve lidhur me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme. Gjithashtu do të nënshkruhet dhe një Memorandum Bashkëpunimi me qëllim ngritjen e grupeve të përbashkëta kontrolli/inspektim midis AKEP dhe AMA me synim verifikimin shterues të zbatimit të kërkasave ligjore.

Treguesit që do të shërbejnë për të matur arritjen e qëllimeve të opsionit të preferuar, do të jenë të varuar nga treguesit e AMA në lidhje me numrin e ankesave të marra në shqyrtim si dhe me qëllim zbatimin e vendimeve të KA-së pranë AMA, lidhur me respektimin e kufizimeve lidhur me përmbajtjet e paligjshme.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			